

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TE KOSOVES

Në pajtim me autoritetin që i është dhënë në nenin 17.b të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/24, të datës 1 Tetor, 2001 mbi ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/20, mbi autoritetin bankar dhe të pagesave të Kosovës, dhe nenit 3.3 të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25 të datës 5 Tetor, 2001 mbi licencimin, mbikqyrjen dhe rregullat e kompanive të sigurimit dhe ndërmjetësuesve të sigurimit.

Me qëllim të zbatimit të nenit 49 të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25

Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar dhe i Pagesave të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 28 Mars, 2002 ka miratuar me sa vijon:

Rregulli 22 mbi Përshkrimin e Kërkesave Shtesë, që të Përfshihen në Letrën Angazhuese të Revizorit të Jashtëm

Neni 1

1. Shtrirja e Rregullit

Ky Rregull aplikohet për të gjitha kompanitë e sigurimit të licencuar nga BPK-ja

2. Autoriteti Ligjor

Ky rregull plotëson nenin 49, kapitulli VII të rregullores së sigurimeve, që kërkon nga BPK-ja të bëjë përshkrimin e kërkesave shtesë të cilat duhet të përfshihen në letrën angazhuese të revizorit të jashtëm, të një kompanie të licensuar. Ajo duhet të interpretohet së bashku me nenin 49, kapitulli VII të rregullores së sigurimeve.

3. Definicionet

Në këtë rregull, termet që vijojn kanë këtë kuptim:

“Bordi i drejtorëve” nënkupton rangimin më të lartë të trupit udhëheqës të një korporate të përbërë nga anëtarët të zgjedhur me të drejtën e votës së aksionarve. Në këtë rregull, termi “bordi i drejtorëve” i referohet:

- a) Në rast të korporatës apo kompanisë të themeluar dhe ekzistuese nën ligjet e Kosovës, bordi i drejtorëve e organizon vetën.
- b) Në rast të kompanisë së huaj, të inkuorporuar në ndonjë juridiksion tjetër, por e cila është e licensuar të bëjë biznes sigurimi në Kosovë, zyrtari i lartë i zyrës së kompanisë në Kosovë, i cili është banor i Kosovës dhe i pranuar nga BPK-ja si i tillë.

Bordi i referohet bordit të drejtorëve siç u definua në këtë rregull.

“Revizori i Jashtëm” nënkupton një individ, partneritet, bashkupim, shoqëri apo firmë, e angazhuar në biznes të interpretimit të shërbimeve revizuese profesionale, duke poseduar edukimin e nevojshëm, trajnimin dhe kualifikimin për të shprehë mendime lidhur me kushtet financiare dhe rezultatet e operimit të kompanisë së licensuar, funksionimi i së cilës si i tillë është miratuar dhe pranuar nga BPK-ja.

“Kompania e licensuar” apo “kompania” i referohet njëres apo të dyjave, kompanisë së sigurimit apo kompanisë ndërmjetësuese.

“Zyrtar i lartë” është rangi më i lartë i zyrtarit të një kompanie të licensuar, pa marrë parasysh se a e përdor titullin e “kryetarit”, “nënkryetarit”, “drejtorit menaxhues”, “përfaqësues i vendit”, “menaxher” apo tituj të tjerë.

Neni 2

Çështjet që Kërkohen për t’u Përfshirë në Letrën Angazhuese të Revizorit të Jashtëm

1. Kërkesat nën nenin 49 të rregullores së sigurimeve

Termet, kushtet dhe çështjet e kërkuara që të përfshihen në letrën e angazhimit të revizorit të jashtëm, të një kompanie të licensuar, të përshkruara nën nenin 49 të rregullores së sigurimeve, në përmbledhje, përfshinë me sa vijon:

- a) Frekuenca e revizorit. Kompanitë e licensuara duhet të kenë raportin e tyre financiare të revizuar për çdo vit, konform periudhës së tyre financiare/kontabilitetit.
- b) Caktimi i revizorit të jashtëm duhet të bëhet me shkrim “letra e Angazhimit” dhe subjekti për miratim nga BPK-ja.
- c) Pavarësia e revizorit. Revizori apo firma e tij nuk duhet të jenë të lidhur

Me palën, siç është definuar në rregullin 27 të kompanisë së licensuar.

- d) Fusha e punës së revizorit duhet të përfshij:
1. Rishikimi i kompetencave të revizorit të mbrendshëm, dhe ushtrimit të Kontrollit të mbrendshëm dhe procedurave, notifikimi i deficitit, dhe bërja e rekomandimeve për implementim.
 2. Shprehja e mendimit, nëse raportet financiare, përfaqësojnë një pamje të drejtë të kushteve financiare dhe aktiviteteve të kompanisë së licensuar në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.
 3. Të prezentojë raportin e revizorit dhe të gjeturat, bordit të drejtorëve të Kompanisë së licensuar.
- e) Shkalla e pajtueshmërisë së rregullave. Raporti i revizorit duhet të shpreh Mendimin nëse kompania e licensuar është në pajtim me rregulloren e sigurimit dhe këto rregulla siç janë aprovuar nga BPK-ja.
- f) Revizori i jashtëm duhet t'i raportoj drejtpërdrejt BPK-së për çështjet me sa
Vijon:
1. Një akt mashtrimi të kryer nga ndonjë punëtor i kompanisë së licensuar apo vartësit të saj, apo ndonjë parregullsi apo deficit në administratë apo operime të cilat mund të jenë të arsyeshme për të rezultuar në humbje të materialit të kompanisë së licensuar.
 2. Nëse kompania e licensuar sistematikisht është në kontradikta me Rregulloren e sigurimeve apo këto rregulla.
 3. Nëse konkluzionet e raportit të revizorit janë të përmbajtura, të injoruara Apo padrejtësisht të influencuara nga menaxhmenti apo bordi i drejtorëve, të kompanisë së sigurimeve, në mënyrë direkte apo indirekte.

2. Çështjet Shtesë që duhet të Përfshihen në Letrën e Angazhimit të Revizorit të Jashtëm

Si shtesë për kërkesat të përshkruara nën nenin 49 të rregullores së sigurimeve, çështjet me sa vijojn duhet poashtu të përfshihen në letrën e angazhimit të revizorit:

- a) Letra e angazhimit duhet të përmbajë nënshkrimin për pëlqim të revizorit, që do të pajtohet me termat dhe kushtet.

- b) Përgjegjësia e bordit të drejtorëve për t'a informuar BPK-në rreth aferave të biznesit të kompanive të sigurimit.
- c) E drejta e revizorit për të komunikuar me BPK-në, për cdo informatë apo mendim në çështjet për të cilat ai mendon se janë relevante për mbikëqyrësit e BPK-së mbi kompanitë e licensuara.
- d) Detyra e revizorit për t'i raportuar BPK-së për çështjet e materialit të rëndësishme.
- e) Detyra e revizorit për të siguruar qasje në letrat e tyre të punës për qëllime rregullative, me kërkesë të BPK-së.
- f) Në rast të krijimit të kompanisë nën ligjet e juridiksionit të huaj:
 - 1. Detyra e zyrtarit të lartë të mbaj rregullatorin e juridiksionit të jashtëm, të informuar për aferat e biznesit të kompanisë; dhe
 - 2. Detyra e revizorit për të informuar autoritetin e rregullatorit të huaj mbi çështjet, lidhur me paragrafet c) dhe d)
- g) Detyra e revizorit për të zbuluar ngjarjet pasuese të cilat janë materializuar, apo në mënyrë të arsyeshme kanë efekt të materializimit, raportet financiare dhe/apo mendimin e revizorit për çështjet.
- h) Detyra e revizorit për të bërë zbulimin mbi transaksionet me personat e afërm dhe çështje tjera subjektive që mund të kërkoen nga BPK-ja, në pajtim me standardet e përgjithshme të zbulimit të pranuar dhe të zbatueshme për kompanitë e sigurimit.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Ky rregull, do të hyj në fuqi me 1 Prill, 2002

David Weatherman
Ushtrues i Detyrës së Drejtorit Gjeneral